

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

## Përmbajtja

FAQJA PREZANTUESE.....	2
Hyrje .....	3
ANALIZA E PROBLEMIT .....	5
Arritje, Probleme dhe nevoja.....	5
REZULTATET E PRITSHME.....	8
Përfituesit.....	9
METODOLOGJIA .....	9
Modulet/Manualet e trajnimit 2017 .....	10
Materialet didaktike .....	11
ASPEKTE ORGANIZATIVE .....	11
Struktura Organizative dhe Personeli .....	11
Drejtoritë mbështetëse .....	12
PLANI I PUNËS DHE KALENDARI I VEPRIMTARIVE .....	12
MONITORIMI DHE VLERËSIMI .....	15
Aktorët pjesëmarrës në zgjedhje.....	15
Misionet e vëzhguesve të zgjedhjeve .....	16
Trajnuesit e kontraktuar nga KQZ.....	16
DETAJE TEKNIKE .....	16
RISKU I PROJEKTIT .....	19
Burimet financiare .....	20
LISTA E SHTOJCAVE BASHKANGJITUR STRATEGJISË .....	20
Lista 1: Temat për programin e trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve	
Lista 2: Procedurat për përzgjedhjen e trajnuesve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve	
Lista 3: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve;	
Lista 4: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KQV-ve, për çdo njësi administrative	

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

## FAQJA PREZANTUESE

- Titulli :** Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017
- Vendi :** **KZAZ, KQV, VNV, në Bashki, në njësi administrative**
- Kohëzgjatja:** **Janar 2017 – Qershor 2017**
- Stafi realizues:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Sekretari i Përgjithshëm  
Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe  
Edukimit të Zgjedhësve  
Drejtoret e tjera në KQZ

### **MISIONI I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE:**

***Rritja e nivelit profesional të komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve, nëpërmjet trajnimeve për mbarëvajtjen e procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave, në funksion të realizimit të zgjedhjeve me standardet më të larta, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.***

### **Shkurtime:**

- KQZ** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- DKZTEZ** Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve
- ST** Sektori i Trajnimeve
- KZAZ** Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
- KQV** Komisioni i Qendrës së Votimit
- GNV** Grupi i Numërimit të Votave
- PMV** Procesverbali i mbylljes së votimit
- KV** Kutia e Votimit
- KVfV** Kutia e Votimit me Fletët e Votimit
- KMV** Kutia e Materialeve të Votimit
- PMV** Procesverbali i mbylljes së votimit

**Komisione zgjedhore** - Komisione zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta  
(KZAZ, KQV, GNV)

**STRATEGJI** - Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet e Kuvendit,  
të datës 18 qershor 2017

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

### Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 21, pika 9 të Kodit Zgjedhor, ka detyrimin ligjor për zhvillimin e trajnimeve për anëtarët e komisioneve zgjedhore, KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në funksion të zbatimit të këtij detyrimi ligjor miraton "Strategjinë e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 18 qershor 2017".

Për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë, korrekt e të paanshëm në përputhje me parimet e Kodit Zgjedhor, aktet nënligjore dhe standartet ndërkombëtare të kërkuara për zgjedhje demokratike, është mëse e nevojshme që strukturat e ngarkuara me ligj për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, të kualifikohen profesionalisht nëpërmjet intensifikimit dhe përmirësimit të trajnimeve përkatëse.

**Qëllimi i strategjisë:** *Përmbushja e detyrimit ligjor për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve, rritja e profesionalizmit të tyre, si element thelbësor për mbarëvajtjen e procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave, në funksion të realizimit të zgjedhjeve me standartet më të larta, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve synon të përmirësojë strategjinë, me qëllim rritjen e cilësisë së trajnimeve, rritjen e standardeve dhe programeve të trajnimeve bazike duke patur parasysh:

- ✓ rëndësinë e trajnimeve për komisionerët zgjedhorë, rritjen e profesionalizmit të tyre, si element thelbësor për standartet e procesit zgjedhor;
- ✓ përmirësimin e metodikës së trajnimit;
- ✓ përcaktimin/shtimin e indikatorëve/njësive të matjes së cilësisë së trajnimit dhe zbatimi i situatave të trajtuara/aplikuara/demostruara në trajnim gjatë punës së komisionerëve zgjedhorë;
- ✓ aftësimin për të përcaktuar saktë situatat problematike, për t'i menaxhuar ato nëpërmjet vendimmarrjes së duhur e të shpejtë për të arritur një standard të lartë performance.
- ✓ zhvillimin dhe përmirësimin e platformës së trajnimit, rritjen e efencës së procesit të trajnimit jo vetëm për komisionerët zgjedhorë, por edhe për target grupe të ndryshme, dhe për të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces.

Marrja e përgjegjësive nga komisionerët zgjedhorë, e gjithë veprimtaria e tyre në administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ, QV dhe veçanërisht në VNV, do të ndihmonte në vlerësimin e zgjedhjeve demokratike, të lira, të drejta dhe të pranuar nga të gjithë.

Në vlerësim të eksperiencës së deritanishme trajnimi përbën një nga drejtimet kryesore të punës për KQZ-në, e cila do të organizojë programme dhe sesione trajnimi për komisionerët zgjedhorë.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

### **Konkretisht, programet dhe sesionet e trajnimit do të ofrojnë:**

- o Njohjen dhe përvetësimin e njohurive mbi Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjorë të KQZ-së, të nxjerra për zbatimin e tij;
- o Aftësimin e komisionerëve në aspektin praktik, për mënyrën e reagimit dhe veprimit në situata të caktuara, duke zbatuar korrektësisht procedurat ligjore;
- o Qendrimin dhe sjelljen ligjore, zbatimin e kodit të sjelljes/etik, gjatë ushtrimit të detyrës dhe veçanërisht në situatë probematike të krijuar në KZAZ, KQV, VNV.
- o Minimizimin e rasteve të komisionerëve të patrajnuar, të cilët duke u shfaqur me paaftësi profesionale si zyrtarë zgjedhorë, shkaktojnë vonesa dhe probleme në procesin zgjedhor.

Strategjia parashikon platformën dhe kornizën e plotë për rritjen e profesionalizmit të anëtarëve të KZAZ-ve, QV-ve dhe GNV-ve, si aktorë, që luajnë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit. Zbatimi i saj do të bëhet nëpërmjet planit të veprimit, parashikuar në vijim, i cili është ndërtuar dhe do të realizohet mbi bazën e analizës dhe qasjes praktike të çdo faze ku kalon procesi zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor (ZAZ), në Qendrën e Votimit (QV) dhe në Vendin e Numërimit të Votave (VNV), siç parashikohet në Kodin Zgjedhor dhe aktet e dala në zbatim të tij. Kjo strategji parashikon në mënyrë të detajuar të gjitha etapat ku do të kalojë procesi i trajnimit të komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve.

Platforma e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18.06.2017, reflekton dhe gjetjet e raporteve të vëzhgimit të organizatave ndërkombëtare dhe vendase për trajnimet e zgjedhjeve të mëparshme, si dhe eksperiencën e përfutur të sesioneve të trajnimit për njohuri të përgjithshme dhe aspekte të veçanta të administrimit zgjedhor, të zhvilluara jashtë periudhës zgjedhore, për të gjithë të interesuarit.

KQZ inkurajon institucionet dhe organizatat vendase apo të huaja të japin kontribut me ekspertizë në fushën e zgjedhjeve në lidhje me trajnimet në drejtim të hartimit të curriculave dhe forcimit të kapaciteteve profesionale.<sup>1</sup>

KQZ do të synojë trajnime për studentët me synimin që ata:

- të fitojnë praktikë zgjedhore,
  - të kenë mundësi për t'u evidentuar si potenciale për t'u angazhuar edhe si trajnerë
- Kështu, ne rrisim akoma më tepër besimin për procesin zgjedhor.

Trajnerët do të jenë në dispozicion edhe për trajnimin e grupeve të interesit për çështje zgjedhore, vëzhgues, përfaqësues të OJF-ve (OJF për mbrojtjen e interesave të personave me aftësi të kufizuara, përfaqësues nga degët lokale të partive politike, përfaqësues të subjekteve zgjedhore, përfaqësues të medias, punonjës të Policisë së Shtetit (në zgjedhjet 2015, KQZ/stafi, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, trajnoi zyrtarët e nivelit të lartë e të mesëm dhe 6 grupe trajnuesish për punonjësit e Policisë së Shtetit "Roli i policisë në zgjedhje", organizuar nga Policia e Shtetit), punonjës dhe/ose nëpunës të administratës publike të ngarkuar me detyra zgjedhore, mësues, studentë, etj.

---

<sup>1</sup>Bazuar në metodologjinë «Bridge», pjesë e projektit "Forcimi i Proceseve Elektorale në Shqipëri", të realizuar gjatë periudhës zgjedhore 2015, mbështetur nga PNUD, UN Women në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

Kjo do të sjellë rritjen e interesimit dhe pjesëmarrjes qytetare, përfshirjen e shumë aktorëve në procesin zgjedhor. Kjo që do të ndikojë në rritjen e transparencës, rritjen e besueshmërisë, menaxhimin e procesit zgjedhor në tërësi, për parandalimin e votimit familjar, shitblerjen e votës, uljen e numrit të fletëve të pavlefshme të votimit, bllokimin e procesit të numërimit të votave, etj.

Strategjia e trajnimit ka afruar një skemë trajnimi të përmirësuar, më praktike për të realizuar trajnime sa më efektive.

## **ANALIZA E PROBLEMIT**

### **Arritje, Probleme dhe nevoja**

Procesi i votimit shënoi rritje të standardeve demokratike, procesi i numërimit u vlerësua përgjithësisht pozitivisht për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015 dhe administrata zgjedhore, e cila realizoi procesin, dëshmoi profesionalizëm, respektoi dhe zbatoi korrektësisht Kodin Zgjedhor.

Platforma e trajnimit dhe programet e trajnimit të organizuara nga KQZ në zgjedhjet e vitit 2015 u vlerësuan në mënyrë pozitive, por u cënua nga emërimet e vonuara dhe lirim/emërimet.


Ky vlerësim pozitiv për trajnimet erdhi si rezultat, sa më poshtë:

- Hartimi i strategjisë së trajnimit, konkrete, praktike dhe e zbatueshme, përmirësimin e organizimit të trajnimeve, përmirësimin e programeve dhe curriculave të trajnimit me standarde.
- Përgatitja e mjeteve didaktike, të kuptueshme dhe praktike për trajnimet, duke përmirësuar metodat didaktike dhe ato vizuale;
- Përzgjedhja e trajnuesve me aftësi trajnuese në përgjithësi dhe në fushën e zgjedhjeve në veçanti;
- Trajnimi me nivel të lartë profesional i trajnuesve;
- Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, me një skemë trajnimi e cila ishte fleksibile e adaptueshme sipas situatave dhe nevojave;
- Përgatitja e logjistikës së trajnimit, të plotë, teknike dhe praktike sipas nevojës dhe planifikimit në strategji;
- Vlerësimet dinamike të ecurisë së trajnimit sipas etapave dhe menaxhimi e zgjidhja në kohë e problematikave.

## Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017

### Elementë tregues që kanë shërbyer si njësi matëse për vlerësimin e trajnimit:

- Minimizimi i incidenteve në ZAZ, QV dhe VNV;
- Dorëzimi i rregullt i bazës materiale.
  - ✓ në vitin 2015, Kuti "E PARREGULLT": 3 kuti votimi nga 15 903 (10 602 kuti votimi dhe 5301 kuti të materialeve të votimit) në Elbasan (1 Kuti Votimi dhe 2 KMZ), Korçë (1 Kuti Votimi), Lezhë (1 Kuti Votimi);
  - ✓ në vitin 2013, Kuti "E PARREGULLT": 6 Kuti nga 11 016 (5508 kuti votimi dhe 5508 kuti të materialeve të votimit).
- Ulja e numrit të ankimeve ndaj vendimeve të KZAZ-së.
- Eksperienca e trajnuesve, në mënyrë të veçantë për zgjedhjet.



Proces mjaft i rëndësishëm ishte dhe përzgjedhja e trajnuesve me procedurë transparente, bazuar në proces të hapur konkurimi.

1. Trajnuesit e KZAZ-ve janë automatikisht trajnues për KQV-të e GNV-të, sepse janë testuar në trajnimin TOT.
2. Në përzgjedhjen e trajnuesve të KQV-ve e GNV-ve mbahet parasysh kontigjenti i trajnuesve të KZAZ-ve, i përzgjedhur automatikisht pasi këta trajnues i janë nënshtruar trajnimit dhe testimit (Programi i Trajnimit të Trajnuesve të KZAZ-ve, TOT).
3. Grafiku tregon se eksperienca zgjedhore e trajnuesve në vitin 2015 krahasuar me vitin 2011 është rritur:
  - 19 % për trajnuesit e KZAZ-ve,
  - 2 % për trajnuesit e KQV-ve
  - 31 % për trajnuesit e GNV-ve

Profesionalizmi i trupës së trajnuesve përcaktohet edhe nga *vazhdimësia e qendrueshmëria në angazhimin e tyre pranë KQZ-së.*

## Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017

- **Trajnimi i KZAZ-ve**, mund të cilësohet si programi më eficient i platformës së trajnimit për zgjedhjet 2015. Kjo për arsye se, ky nivel i administratës zgjedhore funksionon për një periudhë të gjatë kohore, nivelit arsimor dhe përgjegjshmërisë së komisionerëve të emëruar, rregullimit ligjor që moskalimi i testit përbën shkak për shkarkim nga detyra. Rezultatet e testeve të komisionerëve të KZAZ-ve (të zhvilluar pas çdo programi trajnimi), dëshmojnë për nivelin e lartë të njohurive të përfituara.

### Pjesëmarrja në trajnime, 2015


Pjesëmarrja në trajnimin e KZAZ-ve, sipas propozimeve të partive politike %											
Trajnimi	Total	PS	Femra	PD	Femra	LSI	Femra	PR	Femra	Sekretare	
										PS	PD
1	84	31	41	31	35	11	12	11	2	25	14
2	88	31	38	32	36	14	11	11	11	31	17

**Risi:** Për herë të parë testim të komisionerëve për programin e dytë të KZAZ-ve.

- Trajnimi i KQV-ve 1 (një) ditë, u realizua në afatet limit të procesit, për shkak si emërimet e vonuara apo zëvendësimeve. Trajnimi u zhvillua edhe një ditë para datës së zgjedhjeve<sup>2</sup>. Pavarësisht masave të ndërmarra nga KQZ duke e shtrirë trajnimin në të gjithë territorin e vendit dhe ofruar atë për një periudhë të shtrirë në kohë.

Pjesëmarrja e komisionerëve në sesionet e trajnimit, 50%, shifër e cila dëshmon se<sup>3</sup>.

Pjesëmarrja %	PS %	PD %	LSI %	PR %	Femra %	Komisionerë me eksperiencë në %
50	48	31	17	4	16	50



- Trajnimi i GNV-ve, për shkak të emërimeve të vonuara, anëtarët e grupeve të numërimit u trajnuan edhe përpara se të fillonte procesi i numërimit të votave në VNV.

TRAJNIMI I GNV-ve						
Data e trajnimit	Nr. Pjesëmarrësve	PS	PD	LSI	PR	Të Zëvendësuar pas trajnimit
19	707 (47 KZAZ)	31%	24%	32%	13%	
20	424 (30 KZAZ)	30%	29%	23%	18%	
21	933 (58 KZAZ)	29%	28%	22%	21%	17%
22	810 (32 KZAZ)	27%	25%	26%	22%	22%
23	119	22%	24%	25%	29%	21%
24	31	32%	23%	23%	23%	
<b>Total</b>	<b>3024</b>	<b>29%</b>	<b>26%</b>	<b>25%</b>	<b>20%</b>	<b>20%</b>

<sup>2</sup> Gjatë shpërndarjes së bazës material zgjedhore nga KZAZ për KQV-të në juridiksion.

<sup>3</sup> Nga totali i komisionerëve që morrën pjesë në sesionet e trajnimit, 48 % të prozuar nga PS, 31% të propozuar nga PD, 17% të propozuar nga LSI dhe 4% të propozuar nga PR.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

Të dhënat e raporteve të trajnerëve në përmbyllje të trajnimit, dëshmojnë për vlerësime të komisionerëve për cilësinë e trajnimit, dhe cilësinë e materialeve të trajnimit.

Përveç trajnimeve të drejtëpërdrejta u ofrua edhe trajnimi on-line, në zgjedhjet, për trajnuesit dhe komisionerët e të gjitha niveleve me programe trajnimi/module. Kjo eksperiencë pozitive për trajnimin on-line është e nevojshme të vijojë edhe për këto zgjedhje.

Problematika që çënuan efektivitetin e trajnimeve:

- Partitë politike, nuk i paraqitën propozimet për anëtarë të KQV dhe GN në afatin e duhur ligjor, megjithë apelin e vazhdueshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Lirimet/emërimet e komisionerëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve edhe pas trajnimit të tyre nga KQZ;
- Zëvendësimi i anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve, sidomos ditën e zgjedhjeve, me komisionerë të pa trajnuar;
- Mosparaqitja e komisionerëve për t'u trajnuar në kohën dhe vendin e trajnimit;
- Trajnimi i komisionerëve nga vetë partitë politike;
- Anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve, gjatë zhvillimit të sesioneve të trajnimit, nuk pranonin të identifikoheshin duke mos nënshkruar në listën e pjesëmarrjes në trajnim.

Vështirësitë e sipërcituara, që çënojnë cilësinë dhe efikasitetin e trajnimit, evidente edhe në raportet përfundimtare të OSCE/ODIHR për zgjedhjet e mëparshme 2005, 2007, 2009, 2011, 2013, 2015, dëshmojnë probleme të cilat gjenerohen nga veprime/qëndrime të partive politike, dhe nuk mund të gjejnë zgjidhje vetëm me angazhimin e KQZ-së.

### **REZULTATET E PRITSHME**

Realizimi i kësaj strategjie synon:

- Përzgjedhjen e trajnuesve me eksperiencë zgjedhore;
- Realizimin me cilësi dhe profesionalizëm programin e trajnimit të trajnerëve;
- Realizimin me cilësi dhe profesionalizëm programin e trajnimit me anëtarët e emëruar në KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të;
- Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të trajnuesve;
- Rritjen e pjesëmarrjes së komisionerëve zgjedhorë, në programet e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja;
- Rritjen dhe përforcimin e njohurive mbi Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore në zbatim të tij, tek komisionerët zgjedhorë të të gjitha niveleve;
- Zbatimin me korrektësi të ligjit zgjedhor dhe procedurave ligjore, në ZAZ, QV dhe VNV, për plotësimin e standardeve zgjedhore;
- Zgjidhjen me profesionalizëm, paanshmëri, efektivitet nga ana e komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve (KZAZ, KQV, GNV), për çdo problematikë të krijuar gjatë ushtrimit të detyrës;
- Rritjen e standardeve për mirëadministrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor;
- Zvogëlimin e numrit të ankimeve nga subjektet zgjedhore.



## Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017

### Përfituesit

Përfitues të drejtëpërdrejtë do të jenë:

- Komisionerët zgjedhorë (KZAZ, KQV, GNV) në funksion të menaxhimit dhe mirëadministrimit tërësor të procesit në zonën e administrimit të zgjedhjeve, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në funksion të përmbushjes të misionit dhe zbatimit të detyrimeve të tij ligjore kushtetuese.
- Zgjedhësit dhe aktorët zgjedhor (subjektet zgjedhore, kandidatët për deputet, etj.) , të cilët do të kenë mundësi të marrin një shërbim cilësor, ligjor, transparent dhe të paanshëm me komisionerë të trajnuar;
- Trajnuesit e komisioneve të të gjitha niveleve (KZAZ, KQV, GNV-ve).

### METODOLOGJIA

Kurrikulat dhe metodologjia që KQZ miratoi dhe realizoi për të gjitha programet e trajnimit për zgjedhjet vendore 2015, u përgatitën nga Sektori i trajnimit/DKZTEZ mbështetur në eksperiencën e fituar në vite, me synimin për t'i transmetuar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme konceptet ligjore, shoqëruar me ilustrime praktike.

- i.* Përgatitja e dy manualeve trajnuese të KZAZ-së me fletore pune përkatëse dhe Aneksi i Manualit të KZAZ-së, pjesa e parë, me procedura të rëndësishme, si regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i kandidimit, etj. *(pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, në prill 2015, dispozitat e kuotës gjinore).*
- ii.* Përgatitja e Manualit të KQV-së dhe Manualit të GNV-së me procedura të hollësishme, të cilat reflektojnë ndryshimet e Kodit Zgjedhor, kuadrin nënligjor të miratuar nga KQZ për këtë proces, veçanërisht qartësimin e procedurave të reja ligjore për mënyrën e administrimit të votës në kutinë e gabuar, dispozitat e Kodit Penal për vepra penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet.
- iii.* Përmirësimi i Fletores së punës së KQV-së, duke shtuar numrin e shembujve, për menaxhimin e të gjitha situatave në KQV dhe duke dhënë mënyrat e zgjidhjes së tyre.
- iv.* Përgatitja e videos së trajnimit të KQV, me mbështetjen e UNDP-së. Për herë të parë, video e trajnimit të KQV-së përfundon me pyetje pas çdo leksioni të saj, për të testuar nivelin e njohurive të marra gjatë leksionit.
  - ❖ Publikimi i Videos për trajnimin e KQV-së në faqen zyrtare të KQZ-së për çdo të interesuar dhe rrjete sociale.
- v.* Përgatitja e CD-i e prezantime, fleep-chart për t'i ardhur në ndihmë komisionerëve të niveleve të dyta e të treta si gjatë trajnimit, ashtu dhe gjatë ushtrimit të detyrës.
- vi.* Shpërndarja e materialeve të trajnimit paraprakisht me e-mail, bëri që trajnimi të ishte më interaktiv, pasi trajnuesit u familjarizuan me përmbajtjen dhe u fokusuan në problemet, duke sjellë shembujt konkret të hasura në zgjedhjet e kaluara. Kjo solli rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së trajnimit.

Programet aplikative/module për trajnimin on-line për funksione të ndryshme të administrimit zgjedhor (KZAZ, KQV, GNV), të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, ishin një mundësi tjetër për t'i ardhur në ndihmë trajnuesve dhe komisionerëve zgjedhorë për rritjen e profesionalizmit të tyre.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

Kjo metodologji do të përdoret në zgjedhjet 2017 jo vetëm për trajnuesit e të gjitha niveleve, por edhe për komisionerët zgjedhorë, pasi në trajnim ata do të familjarizohen më shpejt me programin dhe përvetësojnë atë, gjithashtu sqarojnë çdo paqartësi.

### **Modulet/Manualet e trajnimit 2017:**

Përmirësimi i metodave didaktike (materiale të shkruara, si manuale, fletore), dhe metodave vizuale (video) do të jetë një objektivi tjetër i platformës së trajnimit.

Mjetet didaktike, do të jenë gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të KQZ-së. Krahas trajnimit të drejtëpërdrejtë do të vijojë trajnimi on-line për personat e interesuar, për trajnuesit dhe komisionerët e të gjitha niveleve. Manualet/modulet do të jenë edhe në faqen për trajnim online sipas tematikave të caktuara në këtë strategji.

Manuali i KZAZ-së do të përgatitet në një manual dhe një fletore pune, sepse detyrat e anëtarëve të KZAZ në këto zgjedhje janë më të pakta.

Anëtarët e KZAZ-ve do të trajnohen në dy programe, dhe në programin e dytë do të trajtohen shembuj të menaxhimit të situatave në ditën e zgjedhjeve, KZAZ, KQV dhe VNV (*Vendimarrja KZAZ-së, raste studimore*).

Përveç përgatitjes së Manualit standard të trajnimit të anëtarëve të KQV-ve do të përgatitet dhe:

- Manual me koncepte bazë, në dispozicion të çdo anëtari të KQV-së. Formatit dhe përmasat do të jenë sa standardi që udhëzon për një GUIDË.
- Fletorja e Punës së KQV-së, me shtimin/pasqyrimin e shembujve të tjerë, raste studimore, do të përmirësohet dhe do të përdoret si "Guidë" nga trajnuesit dhe komisionerët, si dhe çdo i interesuar.
- Përgatitja e modeleve (minichart/në formë tabelle) për detyrat e kryetarit dhe sekretarit të KQV-së.
- Manual me paraqitje grafike të rasteve të votës së vlefshme dhe të pavlefshme me qëllim që ta përdorin të gjithë anëtarët e KZAZ-ve dhe GNV-ve.
- Video trajnuese për sesionet e trajnimit për:
  - ✓ KZAZ, "Për marrjen dhe dorëzimin e bazës materiale nga KZAZ-KQV dhe anasjelltas"
  - ✓ GNV, procedura e numërimit dhe vlerësimit.
- Guidë e Trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve me ekspertë ndërkombëtar dhe ndërinstytucional.

Metodologjia e trajnimit do të fokusohet në:

- ❖ Rëndësinë e komunikimit, si një proces i rëndësishëm në trajnim, për ta bërë mjedisin ku punohet sa më dinamik, të larmishëm, interaktiv, për të kaluar etapat e marrjes së njohurive.
- ❖ Organizimin e punës në grup, ku të ndihet fryma e bashkëpunimit, mbi bazën e polemikës dhe alternativave;
- ❖ Dhënien e informacioneve, që shfaqen në videoprojektor, në mënyrë që audienca të ndërgjegjësohet dhe të kuptojë konkretisht temën e trajnimit. Gjatë zhvillimit të trajnimit, trajneri zgjeron informacionin nëpërmjet veprimeve praktike dhe për çdo pikë zhvillohen diskutime me pjesëmarrësit;
- ❖ Simulimin praktik (demostrim) të proceseve, që zhvillohen në KZAZ dhe KQV, duke realizuar situatat ku kalon procesi zgjedhor, si dhe situata problematike, të hasura në praktikë në proceset zgjedhore të kaluara, me qëllim dhënien e udhëzimeve për zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve, gjatë procesit zgjedhor në funksion të mirëadministrimit të procesit;

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

- ❖ Diskutime të rasteve problematike, që janë hasur gjatë zgjedhjeve nga vetë pjesëmarrësit me eksperiencë zgjedhore dhe udhëzime të trajnuesit për evitimin e këtyre situatave;
- ❖ Ilustrim me foto, pamje filmike (video);
- ❖ Diskutime të hapura: *shembuj nga rastet në zgjedhjet 2009-2016, (marrja e njërës nga vulat, "çarja/dëmtimi i kutisë së votimit, por që evidentohet pas fillimit të votimit", "mbyllja e kutisë së votimit me kapakun e kutisë së materialeve zgjedhore, votimi për të tretët (gruaja/nusja/vajza voton për burrin/vjehrrin/babain emigrant), zgjedhësi dhe lista e zgjedhësve, fleta e dëmtuar, fotografimi i votës/shitblerja e votës, letër njoftimi/pasaporta pak e dëmtuar, pretekst për të bërë debat, trajtimi i rasteve të veçanta si personat e martuar, që nuk kanë ndryshuar mbiemrin në dokumentin e identifikimit, dorëzimi i vulave dhe Procesverbalit i Mbylljes së Votimit, PV-KQV-08, dorazi nga KQV-të në KZAZ, bllokimi i procesit të numërimit).*
- ❖ Njohja me Testet kualifikuese për KZAZ, KQV-të dhe GNV-të nëpërmjet shembujve;
- ❖ Testimi.

### **Materialet didaktike:**

- Manuale: KZAZ, KQV, GNV me ilustrime (foto dhe figura me ngjyra për çdo procedurë);
- Fletore pune: KZAZ, KQV, me modele dhe shembuj të plotësuar;
- Flip chart;
- Videoprojektor;
- Kompjuter;
- Ilustrime me: *foto, pamje filmike dhe diçitura për të shtuar efektin e ligjëratës, për të thyer monotoninë, për të praktikuar aftësitë për zgjidhjen e problemeve;*
- Fletë adezive me modele të vlerësimit të votave "te vlefshme " dhe të "pavlefshme";
- CD, që përmbajnë:
  - Video;
  - ✓ Prezantimet në poëerpoint;
  - ✓ leksionet e përgatitura nga lektorët për sesionet trajnuese;
  - ✓ modelet e dokumentacionit të punës, për procedura zgjedhore të caktuara në KZAZ, KQV, GNV.

Programet trajnuese me komisionerët zgjedhorë do të ndihmohen e mbështeten nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të KQZ-së (web) të materialeve trajnuese, moduleve (trajnimit online), dhe njoftimet për trajnimet sipas programeve.

- Komisionerët do të trajnohen për:
  - procedurat e votimit të zgjedhësve PAK,
  - mënyrën e përdorimit të mjeteve të posaçme të votimit nga kjo kategori zgjedhësish.

## **ASPEKTE ORGANIZATIVE**

### **Struktura Organizative dhe Personeli**

Zbatimi i strategjisë së trajnimit, do të mbikëqyret nga KQZ-ja.

Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, do të ndjekë dhe përgjigjet për përgatitjen, organizimin, mbarëvajtjen dhe monitorimin të programit të trajnimit në të gjithë komponentët që e shoqërojnë atë.

Drejtores e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore është koordinatore e projektit, e cila në bashkëpunim me Përgjegjësen e Sektorit të Trajnimit do të ndjekin dhe informojnë për:

- Zbatimin e programeve të trajnimit;
- Zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së trajnuesve.

## Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017

Në përfundim, DKZTEZ/ST do të bëjë analizë të realizimit të programeve/sesioneve të trajnimit, bazuar në rezultatet e monitorimit, dhe raportet e trajnerëve.

Personeli i angazhuar, për realizimin e strategjisë do të jetë:  
Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe stafi DKZTEZ.

### Drejtoritë mbështetëse

Realizimin e kësaj Strategjie, si edhe koordinimin dhe mbarëvajtjen tërësore të procesit zgjedhor, do ta mbështesin sipas detyrave të tyre funksionale: *Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Logjistikës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtoria e Financës.*

### PLANI I PUNËS DHE KALENDARI I VEPRIMTARIVE

Në këtë plan pune janë paraqitur veprimtaritë/shërbimet e DKZTEZ/Sektorit të Trajnimit për realizimin e strategjisë së trajnimit.

#### Kalendari i veprimtarive

NR	VEPRIMTARITË	PËRGJEGJËSI	AFATI
1	Njoftimi në faqen zyrtare të KQZ-së (web), median elektronike, për : - numrin e trajnuesve për çdo qark; - kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit të trajnuesit; - dokumentacionin që duhet të dorëzojnë; - afatin kohor të dorëzimit të dokumentacionit; - vendin e zhvillimit të intervistës për përzgjedhjen e trajnuesve të KZAZ, KQV, GNV.	DKZTEZ/ST/ DTI/DBNJ/ DShL	Jo më vonë se 23 janar
2	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit të KZAZ, dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 10 shkurt
3	Intervista e trajnuesve	DKZTEZ/ST/ DBNJ	Jo më vonë se 18 shkurt
4	Përzgjedhja trajnuesve	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 25 shkurt
5	Vendimmarrja për miratimin e trajnuesve	SEK. PERGJITHSHEM	Jo më vonë se 25 shkurt
6	Njoftimi në faqen zyrtare të KQZ-së (web) i listës së trajnuesve të përzgjedhur/miratuar	DKZTEZ/ST/ DBNJ	Jo më vonë se 1 mars
7	Përgatitja e programit të parë trajnues me logjistikën përkatëse për anëtarët e KZAZ-së	DKZTEZ/ST/ DShL	Jo më vonë se 15 mars

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

<b>8</b>	Trajnimi i stafit të përkohshëm të sektorit trajnimit	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 17 mars
<b>9</b>	Trajnimi i trajnuesve të KZAZ-ve	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 18 mars
<b>10</b>	Njoftimi i subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, IRZ, në lidhje me skemën/kalendarin për zhvillimin e programit të parë të trajnimit me anëtarët e KZAZ-ve.  Njoftimi në median elektronike	DKZTEZ/ST/ DShL	Jo më vonë se 15 mars
<b>11</b>	Trajnimi i parë i anëtarëve të KZAZ-ve	DKZTEZ/ST dhe Trajnuesit	Jo më vonë se 30 mars
<b>12</b>	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit të KQV-së dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 10 prill
<b>13</b>	Përgatitja e programit trajnues me logjistikën përkatëse për anëtarët e KQV-së	DKZTEZ/ST/ DShL	Jo më vonë se 8 maj
<b>14</b>	Njoftimi subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, MAS, DAR, IRZ, në lidhje me skemën/kalendarin për zhvillimin e trajnimit të anëtarëve të KQV-ve  Njoftimi në median e shkruar dhe elektronike	DKZTEZ/ST/ DShL	Jo më vonë se 18 maj
<b>15</b>	Trajnimi i trajnuesve të KQV-ve	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 27 maj
<b>16</b>	Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve	DKZTEZ/ST Trajnuesit	Jo më vonë se 2 qershor
<b>17</b>	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit trajnues për grupet e numërimit të votave (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 1 maj
<b>18</b>	Përgatitja e programit trajnues me logjistikën përkatëse për anëtarët e GNV-ve	DKZTEZ/ST DShL	Jo më vonë se 8 qershor
<b>19</b>	Njoftimi në median e shkruar dhe elektronike, në lidhje me skemën/kalendarin për zhvillimin e trajnimit me anëtarët e GNV-ve	DKZTEZ/ST/ DShL	Jo më vonë se 8 qershor
<b>20</b>	Trajnimi i trajnuesve të GNV-ve	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 12 qershor

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

<b>21</b>	Njoftimi i subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, inspektorëve rajonalë në lidhje me skemën/kalendarin për zhvillimin e programit të dytë të trajnimit me anëtarët e KZAZ-ve  Njoftimi në median elektronike	DKZTEZ/ST/  DShL	Jo më vonë se 10 qershor
<b>22</b>	Trajnimi i dytë i anëtarëve të KZAZ-ve	DKZTEZ/ST  Trajnuesit	Jo më vonë se 14 qershor
<b>23</b>	Trajnimi (specifik) i operatorëve, sekretarëve dhe kryetarëve të KZAZ-ve, në seanca 3 orëshe	DKZTEZ/ST  DTI	Jo më vonë se 13 qershor
<b>24</b>	Trajnimi i anëtarëve të GNV-ve në Vendin e Numërimit të Votave	DKZTEZ/ST  Trajnuesit	Jo më vonë se 15 qershor
<b>25</b>	Trajnim specifik, para marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore, me kryetarin, sekretarin e KQV-së dhe anëtarë që mund të jenë të pranishëm	DKZTEZ/ST dhe  Trajnuesit, KZAZ-të	17 qershor, ora 9 <sup>00</sup> -12 <sup>00</sup>
<b>26</b>	Dorëzimi në KQZ i materialeve trajnuese, dokumenteve raportuese për realizimin e trajnimit	DKZTEZ/ST, DShL dhe Trajnuesit	Jo më vonë se 25 qershor
<b>27</b>	Takim në Tiranë me trajnuesit KZAZ-ve dhe IRZ: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i realizimit të programeve të trajnimeve, për këmbimin e praktikave më të mira gjatë procesit zgjedhor, analiza lidhur me përmirësimin dhe modifikimin e metodave të përdorura për programet trajnuese në të ardhmen.</li> <li>• Hartimi i raportit vlerësues përfundimtar</li> </ul>	DKZTEZ/ST	Pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve

**Për çdo trajnim,**

- Sensibilizimi i subjekteve zgjedhore në median elektronike nga ana e KQZ-së, për rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e trajnimit (realizimi i një video për sensibilizim e të gjithë aktorëve që ndikojnë për pjesëmarrjen e komisionerëve zgjedhorë në trajnime, në veçanti komisionerët e KQV-ve dhe numëruesit e votave);
- Përgatitja e logjistikës trajnuese për zhvillimin e programit trajnues me anëtarët e KQV-ve në koordinim me Zyrat Rajonale Zgjedhore;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit (Drejtoritë Arsimore Rajonale në qarqe) për vënien dhe gadishmërinë e ambienteve shkollore në dispozicion të realizimit të trajnimeve;
- Koordinimi me ofruesin e shërbimit për transportimin e bazës materiale trajnuese në njësitë vendore/njësitë administrative;
- Monitorimi i trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve nga KQZ-ja, DKZTEZ dhe IRZ;
- Raportimi/Relacioni mbi realizimin e programit të trajnimit për Anëtarët e KQZ-së.

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

## **MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

Monitorimi i realizimit, të ecurisë, cilësisë, efektivitetit, transparencës së programeve të trajnimeve dhe standardit të tyre, do të kryhet nga:

- KQZ-ja (Anëtarët) dhe administrata e insitucionit: Sekretari i Përgjithshëm, DKZTEZ;
- Aktorët pjesëmarrës në zgjedhje (politik dhe jopolitik);
- Misionet e vëzhguesve vendas dhe të huaj të akredituar nga KQZ-ja;
- Trajnuesit dhe anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, përfitues të drejtëpërdrejtë nga trajnimet.

### **Monitorimi dhe vlerësimi nga KQZ-ja:**

Për një gjykim sa më objektiv të suksesit të programit, si njësi matëse për vlerësimin do të shërbenin elementët tregues që shoqërojnë projektin në tërësi, si:

- Respektimi i procedurave të përzgjedhjes së trajnuesve sipas afateve kohore dhe planifikimit;
  - Niveli dhe performaca e realizimit të programit të trajnimeve nga stafi i DKZTEZ/ST dhe drejtoritë e tjera bashkëpunuese në këtë program trajnimi;
  - Niveli dhe performanca e realizimit të programit të trajnimeve nga trajnuesit sipas programeve për (KZAZ-të, KQV-të, GNV-të);
  - Pjesëmarrja e komisionerëve zgjedhorë në trajnime dhe krahasimi i numrit të anëtarëve të KZAZ, KQV dhe GNV të trajnuar në vite;
  - Niveli i njohurive të anëtarëve të KZAZ-ve të marra gjatë procesit të trajnimit ( *i reflektuar nga rezultati i testimit të tyre kualifikues, si edhe nga veprimtaria korrekte dhe ligjore e ndjekur nga KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të*);
  - Pakësimi në përqindje i kundërshtimeve dhe minimizimi i incidenteve në ZAZ, QV dhe VNV;
  - Pakësimi i numrit të ankesave kundër vendimeve të KZAZ-së (raporti 2009-2017), i cili do të jetë një tregues i profesionalizmit dhe paanësisë së komisionerëve;
  - Raportet për monitorimin e zgjedhjeve.
- ❖ Organizmat vendase apo të huaja mund të na ofrojnë edhe metodologjitë e tyre, për matjen e ndikimit dhe për rezultatet e trajnimeve.

### **Aktorët pjesëmarrës në zgjedhje**

Programi i trajnimit mund të ndiqet, monitorohet dhe vlerësohet edhe nga aktorët pjesëmarrës në procesin zgjedhor.

Realizimi me transparencë i trajnimeve ju garanton aktorëve të ndjekin se si zbatohet dhe realizohet programi i trajnimit, sipas skemës/kalendarit të miratuar nga KQZ-ja dhe të publikuar.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

### **Misionet e vëzhguesve të zgjedhjeve**

Programet e trajnimeve monitorohen dhe vlerësohen nga monitorues e koalicione vendase dhe vëzhgues të huaj të akredituar nga ana e KQZ-së.

Sipas praktikës dhe eksperiencave të mëparshme zgjedhore, këto grupe monitorimi publikojnë dhe prezantojnë raportet e tyre, sipas etapave që kalon procesi zgjedhor dhe në përfundim të tij.

Në këtë kontekst mendimet, sugjerimet, vlerësimet dhe rekomandimet e tyre do të merren në konsideratë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së performancës të realizimit të trajnimeve në etapat pasardhëse, por edhe për punën e KQZ-së në të ardhmen.

### **Trajnuesit e kontraktuar nga KQZ**

Sipas termave dhe detyrimeve kontraktuale, trajnuesit do të raportojnë gjatë ditës së trajnimit, në përfundim të ditës së trajnimit dhe në përmbyllje të procesit zgjedhor, si dhe do të administrojnë listë prezencat e pjesëmarrësve në trajnim.

Trajnuesit pas çdo programi trajnimi do të përgatisin raporte me të dhëna, për ecurinë e trajnimit sipas modelit standard të raportimit nga DKZTEZ/ST.

Këto raporte, të shoqëruara me listat e pjesëmarrjes në trajnim të nënshkruara nga komisionerët, do të administrohen nga stafi DKZTEZ/ST në funksion të krijimit të bazës së të dhënave për komisionerët zgjedhorë, si dhe për evidentimin e problematikave me të cilat janë përballur trajnuesit në punën e tyre.

#### **- Vetë përfituesit e drejtëpërdrejtë nga trajnimet (Anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve)**

Vlerësimi nga përfituesit në trajnime-komisionerët zgjedhorë do të jenë pjesë integrale dhe kontribuese.

Pjesë e përgatitjes së raporteve vlerësuese të ecurisë dhe realizimit të trajnimeve do të jetë dhe pjesa e vlerësimit nga vetë pjesëmarrësit në trajnime/komisionerët zgjedhorë nëpërmjet formës së vlerësimit që do të realizohet në përfundim të çdo sesioni trajnimi dhe çdo ditë.

### **DETAJE TEKNIKE**

Nisur nga eksperiencia dhe rezultatet pozitive të realizimit të trajnimeve në zgjedhjet e mëparshme edhe në këto zgjedhje është menduar që të vazhdojë e njëjta mënyrë organizimi-skemë trajnimi, metoda e trajnimit "Kaskadë" me dy shkallë.

Trajnimi i trajnuesve të komisionerëve zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV) është planifikuar të realizohet në Tiranë.

#### **Argumenti:**

- KQZ menaxhon/monitoron dhe vlerëson efektivitetin dhe cilësinë e realizimit të trajnimit;
- Stafi i KQZ-së ndjek dhe vlerëson nga afër realizimin e trajnimit;
- Shtohet përgjegjësia e trajnuesve ndaj detyrimit për të marrë pjesë në trajnim;
- Vlerësim më real e objektiv i aftësive të trajnuesve.



## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

### **Trajnimi i KZAZ-ve**

#### Trajnimi i trajnuesve të KZAZ-ve

Programi i trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve (54 trajnues) do të zhvillohet në Tiranë, në kohëzgjatje 2 (dy) ditore (2 grupe në dy ditë, të njëpasnjëshme).

Nisur nga eksperiencia e zgjedhjeve të mëparshme, do të trajnohen së bashku me trajnuesit e KZAZ-ve edhe inspektorët rajonalë (28 IZRZ).

Në përfundim të trajnimit trajnuesit do t'i nënshtrohen procedurës së testimit.

Për realizimin e trajnimit secili trajnues do të ketë bazën materiale trajnuese didaktike dhe logjistike, sipas planifikimit.

#### Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve

Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-së do të zhvillohet në dy ditë (një ditë trajnimi për secilin program) nga trajnuesit e KZAZ-ve, sipas skemës/kalendarit të trajnimit të KZAZ-ve.

• **(Lidhja nr. 3).**

Programet e trajnimit, do të zhvillohen në ambientet që do të sigurohen në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, prefekturave, qarqeve, DAR, MAS, etj.

Në rast se trajnuesi mungon, trajnimi është i detyrueshëm dhe do të zhvillohet nga trajnuesi rezervë ose Inspektori Rajonal Zgjedhor ose DKZTEZ/ST.

Në trajnimin e dytë me anëtarët e KZAZ-ve do të trajtohen shembuj/veprime praktike të KZAZ-së për menaxhimin e situatave ditën e zgjedhjeve dhe gjatë numërimit të votave (vendimmarrja e KZAZ-së në KZAZ, KQV dhe GNV).

**Risk:** - mospjesëmarrja e anëtarëve të KZAZ-së në trajnimit;  
- zëvendësimet e komisionerëve të trajnuar.

Trajnimi i dytë, do të zhvillohet tre ditë para ditës së zgjedhjeve, për ta evituar riskun, dhe minimizuar numrin e komisionerëve të patrajnuar.

Anëtarët e KZAZ-ve, pjesëmarrës në programin e parë të trajnimit do t'i nënshtrohen testimit, sipas materialit të përcaktuar në "Testin e organizuar nga KQZ". Testimi i tyre do zhvillohet pas përfundimit të trajnimit të programit të parë. Testimi do të realizohet në prezencën e IRZ (për aq sa është e mundur) , i cili do të konfirmojë procedurën e zhvillimit të testimit me nënshkrimin e tij. DKZTEZ/ST do të përgatisë procesverbalin Tip.

Anëtarët e testuar do të pajisen me dëshminë përkatëse të trajnimit.

Është planifikuar në strategji, por dhe nisur nga eksperiencia pozitive të zgjedhjeve të mëparshme, dhe zgjedhjeve të vitit 2015, që në një ditë të veçantë do të trajnohen sekretarët e KZAZ-ve në KQZ, lidhur me detyrat e tyre të veçanta, si transmetimi i të dhënave (një seancë 3 orë). Ky trajnim të organizohet në bashkëpunim me DTI, sipas një grafiku të caktuar.

Për realizimin e trajnimit secili trajnues do të ketë materialet e nevojshme trajnuese sipas numrit të anëtarëve të KZAZ-ve që do të trajnojnë. Çdo anëtar i KZAZ-ve do të ketë dosjen/set-in me materiale trajnuese.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

### **Trajnimi i KQV-ve**

#### Trajnimi i trajnuesve të KQV-ve

- Programi i trajnimit me trajnuesit e KQV-ve (280 trajnues) do të zhvillohet në Tiranë nisur nga eksperiencia pozitive e zgjedhjeve të mëparshme.

Kohëzgjatja e trajnimit të trajnuesve të KQV-ve do të jetë në 7 ditë, 280 trajnuesit do të ndahen në 7 grupe ( një grup/një ditë).

#### Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve

- Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve do të zhvillohet në një ditë.
- Çdo trajnues do të kryejë 6 ditë trajnim.

Një ditë para ditës së zgjedhjeve për kryetarin, sekretarin e KQV-së do të zhvillohet trajnim specifik i tyre, pasi përgjegjësia për shkak edhe të vetë pozicionit është të sigurojnë çdo veprim gjatë procesit zgjedhor të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore (Kjo seancë do të zhvillohet nga një pjesë e trajnuesve. Trajnuesit e GNV-ve do të angazhohen edhe për të trajnuar anëtarë të KZAZ-ve dhe KQV-ve, në rastet e zëvendësimit të tyre ditën e zgjedhjeve. Ky trajnim do të kryhet *për aq sa është e mundur nga trajnuesi dhe/ose nga sekretari i KQV-së.*

Programi i trajnimit do të zhvillohet *para tërheqjes së bazës materiale* nga trajnuesit e KQV-ve të KZAZ-së përkatëse, në ambientet pranë vendndodhjes së saj.

- Anëtarët e KQV-ve, pjesëmarrës në programin e trajnimit do t'i nënshtrohen procedurës së testimit verbal.
  - Në fillim të çdo sesioni trajnues, komisionerëve të këtij niveli, do t'u shpërndahet set-i me materiale trajnuese si manual, fletore pune të KQV-ve, etj.
  - Seanca trajnuese do t'i referohet temës përkatëse, veprimeve proceduriale, të ilustruara këto me improvizime praktike të procedurave, ku kalon procesi i votimit në QV. Trajtimi i problemeve të ditës së votimit dhe menaxhimi i situatave.
  - Në rast të mungesës së anëtarëve të KQV-së, gjatë zhvillimit të sesionit trajnues, IZRZ dhe vetë Trajnuesi, duhet të njoftojë KZAZ-në përkatëse dhe ST/DKZTEZ.
- **(Lidhja nr. 4)**
- Vendi i trajnimit do të jetë sa më afër vendndodhjes së KZAZ-së, KQV-së.

### **Trajnimi i GNV-ve**

#### Trajnimi i trajnuesve të GNV-ve

Programi i trajnimit me trajnuesit e GNV-ve (94 trajnues) do të zhvillohet në Tiranë. Trajnimi do të realizohet në kohëzgjatje 2 (dy) ditore (2 grupe në dy ditë, të njëpasnjëshme), sipas një skeme të grupimit të ZAZ-ve, sipas qarqeve.

#### Trajnimi i trajnimit të anëtarëve të GNV-ve

Trajnimi i anëtarëve të GNV-ve do të zhvillohet në 1 (një) ditë nga trajnuesit e GNV-ve.

Programet e trajnimit, do të zhvillohen në ambientet që do të sigurohen në bashkëpunim me qeverisjen vendore, DAR, MAS, etj.

## **Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

Edhe në rastin kur do të kemi procedurën e zëvendësimit të grupeve të numërimit (para fillimit të numërimit apo edhe gjatë ditëve të numërimit), grupet e dyta/numëruesit rezervë do t'i nënshtrohen programit të trajnimit, që do zhvillohet në VNV-në përkatëse. Trajnimi mund të realizohet edhe nga trajnuesi rezervë, trajnuesi i KZAZ-së më të afërt, Sekretari/Kryetari i KZAZ-së).

**Risk: a.** mospjesëmarrja e numëruesve ditën e trajnimit.

Trajnimi i numëruesve do të zhvillohet në VNV para fillimit të procesit të numërimit, për ta evituar riskun, dhe minimizuar numrin e numëruesve të patrajnuar.

### **Infrastruktura e trajnimit**

Baza materiale trajnuese do të transportohet nga ofruesi i shërbimit, të kontraktuar nga KQZ-ja, në çdo vendtrajnim të njësive administrative të çdo qarku.

### **Bashkëpunimi i KQZ-së me institucione shtetërore dhe organizata të huaja për realizimin e trajnimeve:**

1. Marrëveshje bashkëpunimi me MASH dhe MÇVendore, për:
  - Ofrimin, vënien në dispozicion të objekteve shkollore, arsimore dhe social kulturore të qarqeve përkatëse në funksion/dispozicion të realizimit të trajnimit sipas skemës/kalendarit të trajnimit;
  - shfytëzimin e sallave të IT-së (kompjuterat dhe vidio projektorët, nëse kanë) në shkollat, ku zhvillohet trajnim.
2. Marrëveshje bashkëpunimi (të kontraktuar) me ofruesin e shërbimit *për transportimin e bazës materiale trajnuese në vendet e trajnimit.*
3. Marrëveshje bashkëpunimi me OSBE dhe KiE për ekspertizë në fushën e zgjedhjeve/trajnimit.

### **RISKU I PROJEKTIT**

Për shkak të natyrës së tij, ky projekt paraqet disa rreziqe specifike:

1. Vonesat, që lindin si rezultat i propozimeve për anëtarë të komisioneve zgjedhore (KZAZ, KQV dhe GNV) nga partitë politike jashtë afateve kohore të emërimit të tyre ligjor, procedurë kjo e lidhur direkt me pjesëmarrjen e tyre në trajnimin e programuar në kohën e duhur.
2. Zëvendësimet e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të trajnuar.
3. Mospjesëmarrja në programet e trajnimit e komisionerëve zgjedhorë.
4. Mosidentifikimi i pjesëmarrësve në trajnim (anëtarë të KQV-ve dhe GNV-ve nuk nënshkruajnë në listën e pjesëmarrjesve, ky fenomen i konstatuar gjatë trajnimeve të kaluara).

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,  
për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017**

## **Burimet financiare**

Për realizimin e këtij projekti do të planifikohen dhe përdoren burimet financiare nga:

- Buxheti i shtetit.
- Bashkëpunimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me organizmat ndërkombëtare kontribues dhe mbështetës për procesin zgjedhor.

Donatorët, organizma ndërkombëtarë/aktorë dhe faktorë vendas, kombëtarë apo lokalë që do të ofrojnë ndihmë dhe do të mbulojnë shpenzimet e këtij projekti, mund ta japin atë në formën e burimeve logjistike apo burimeve financiare.

### **13. REFERENCË:**

- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 21 Qershor 2015,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 8 maj 2011,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 28 Qershor 2009,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 18 Shkurt 2007,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 3 Korrik 2005.

### **LISTA E SHTOJCAVE BASHKANGJITUR STRATEGJISË:**

Lista 1: Temat për programin e trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve

Lista 2: Procedurat për përzgjedhjen e trajnuesve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve

Lista 3: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve;

Lista 4: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KQV-ve, për çdo njësi administrative.